



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal of Kačanik

01Nr.60/01-1778/26
Kaçanik, 27.01.2026

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **I (parë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e 8 e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 27.01.2026, në ora 11:00. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në sallën e komiteteve të KK, me fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Komiteti për Politikë dhe Financa- KPF prej 7 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 7 anëtarët-të gjithë: Selajdin Troni, Lejla Çaka-Muhaxheri, Bashkim Krasniqi, Kadrije Lika-Troni, Ernesta Krasniqi, Ardita Rrahmani, Kjani Zeneli.

Nga Ekzekutivi i Komunës, pjesëmarrës fillimisht ishin pjesëmarrës: Xhelal Dema - Nënkyetar i komunës, Drejtorët e Drejtorive: Suad Dullovi-DBPZHR, Arian Teneqja-DSHPE, Arlinda Rakoci -Raka-DZHET, Valdrin Dogani-DBF, Urata Sopa-DAP, Lumnije Demnika- Selmani-DSHMS, Lulzim Krasniqi-DKRS, ndërkaq me vonë prezantuan edhe: Sabedin Vishi- Kryetari i Komunës dhe Korab Krasniqi-DUKMM. Nga zyrtarët ishin: Makfire Malsiu- Zyrtare e Lartë për Punë të KK, Arianitë Bajrami-Asistente e Kryesuesit të KK, Mavije Murseli – Kabineti i kryetarit.

Nga OSBE, mbledhjen e monitoroj, Faruk Dërmaku.

Mbledhjen e kryesoj, Selajdin Troni, Kryesues i Kuvendit.
Procesmbajtës: Makfire Malsiu, Zyrtare e Lartë për Punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Selajdin Troni, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, materialin e mbledhjes besoj se e keni marrë, e hapi mbledhjen e I (parë) të rregullt të KPF-së për vitin 2026, data 27.01.2026.

znj. Ardita Rrahmani dhe znj. Ernesta Krasniqi, njoftuan se kanë problem me emaile private e zyrtare, ndërkaq theksuan se zyrtarja e KK na ka dërguar në formë tjetër materialin e mbledhjes. Në vazhdim zonja Rrahmani, kërkoj të shtohet kapaciteti i emailit zyrtar, për me na u krijuar mundësi me i marrë materialet. Kjo kërkesë të përcjellët të Zyrës së IT që me rritur kapacitetin e emailit zyrtar.

Kryesuesi i Kuvendit: Të pika 5, drejtori i ka përpunuar fotot se kanë qenë shumë të dobëta, tani janë bërë me ngjyra, ju kemi përcjellë sot KPF dhe KK, ndoshta pak me vonesë për KPF, për KK nuk është vonë. Për këtë takim e kemi paraparë këtë:

REND PUNE

1. Plani i punës i Ekzekutivit të komunës për vitin 2026;
2. Plani i punës i Kuvendit të Komunës për vitin 2026;
3. Propozim Vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSB;
4. Propozim Vendimi për themelimin e Komisionit komunal të Aksionarëve për KRM "Pastërtia" Sh. A- Njësia në Kaçanik;
5. Propozim Vendimi për miratimin e Raportit përfundimtar të komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, në fshatin Ivajë;
6. Deklaratë mbi eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike.

Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 7. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 7 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas renditjes:

2. Plani i punës i Ekzekutivit të komunës për vitin 2026;

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

z. Bashkim Krasniqi: Planin e kam lexuar, është një plan që kishim pasur dëshirë me qenë edhe me voluminoz dhe me pasur me tepër të hyra për realizimin e tij, por kjo po varet prej faktorëve tjerë, prej buxhetit. Unë e kam lexuar me kujdes, ky plan i punës është i mirë, duke u bazuar në buxhetin e komunës, ne kemi me u munduar me përkrahur, që ky plan mos të ngelë vetëm në letër, por të realizohet. Ky plan e ka përkrahjen tonë, besoj se kemi me qenë bashkëpunues që ky plan mos të ngelë vetëm në letër, por të realizohet.

znj. Kadrije Lika Troni: Në plan janë përfshirë objektivat e gjithmbarshme të ekzekutivit të komunës, por nuk kam pa se ka kosto buxhetore për realizimin e këtyre objektiveve. A parashihen kostot buxhetore në kornizën buxhetore për realizimin e këtij plani?

z. Valdrin Dogani: Lidhur me pyetjen e znj. Kadrije Lika Troni, ky plan i punës i hartuar, është i bazuar në buxhetin e komunës të vitit 2026, i aprovuar në shtator të vitit 2025. Në bazë të mundësive buxhetore që ka komuna, janë përfshirë objektivat e përcaktuar si në këtë plan.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim me ia kaluar Kuvendit të Komunës në procedurë të shqyrtimit. Rezultati i votimit ishte njëzëri Për. Prezentë 7. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF, **Shqyrtoj**

Raportin e punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2026 dhe i njëjti i përcjellët Kuvendit të Komunës në procedurë të shqyrtimit.

2. Plani i punës i Kuvendit të Komunës për vitin 2026;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika Troni: Me vjen mirë që në këtë plan pune është futur tetori rozë dhe nëntori 16 ditë aktivizim kundër dhunës në baza gjinore. Në planin e punës së KK nuk e shoh që është paraparë renditja apo renovimi i sallës së KK, vendi ku i mbajmë mbledhjet, ndërkaq kushtet i kemi jashtëzakonisht të dobëta, krahasuar me komunat tjera. Unë mendoj se ju kryesues do ti shtyni përpara kërkesën tonë dhe të grupit tonë të asamblistëve, se vazhdimisht në mandatin e kaluar kemi kërkuar që se paku të jetë një foltore, në mënyrë që për besimin që na kanë dhënë qytetarët, zëri ynë të dëgjohet para foltores.

znj. Ardita Rrahmani: Meqë është mbledhja e parë e KPF, uroj anëtarët e KPF dhe anëtarët e Ekzekutivit për përgjegjësitë e marra, uroj të na shkon puna mbarë. Në krahasim me vitet tjera, në plan pune shënohet se muaji gusht është muaj i pushimit, ndërkaq për 12 muaj na takojnë kompensimet për mbledhje të KK dhe mëditjet për mbledhje të KPF. Pasi është e caktuar me ligj, pse mos me i mbajtur 12 mbledhje të KPF. Të njëjtën kërkesë e kam ngritur edhe në mandatin e kaluar, dhe pse mos me realizuar një diçka që na takon. Sipas këtij plani, janë 11 mbledhje të KPF, se muaji gusht është pushim për anëtarët e KK.

Kryesuesi i Kuvendit: Në vitin 2026 do ti mbajmë 12 mbledhje të KPF. Mundem materialin e një mbledhje me ndarë në dy mbledhje. Sa i përket sallës së KK, nuk janë kushtet e mira të punës. Nëse arrijmë me realizuar me buxhet, mendojmë me ndërtuar një sallë të mirë afër komunës. Nëse nuk mundemi, atëherë duhet me shikuar çka mundemi me ndryshuar në sallën e KK që e kemi.

znj. Kadrije Lika Troni: Veç a është vullneti, se mundemi me krijuar kushte edhe në sallën që e kemi.

znj. Ardita Rrahmani: Një foltore mundet me u bërë në sallën që e kemi, diçka me tepër nuk besoj se mund të intervenohet.

znj. Ernesta Krasniqi: Në sallën që e kemi të KK, është mirë me bërë intervenime, që ne si KK, drejtorët e drejtorive me i pasur përballë, e jo drejtorët me qëndruar prapa shpinës së anëtarëve të KK.

Kryesuesi i Kuvendit: Nuk e di a mundemi me bërë diçka ndërhyrje në sallën aktuale.

znj. Kadrije Lika Troni: A jeni konsultuar me ndonjë inxhinier të fushës, se tani edhe numri i anëtarëve të KK është me i vogël.

Kryesuesi i Kuvendit: Ne e kemi planifikuar me ndërtuar një sallë të re, nëse nuk mundemi, atëherë me shqyrtuar mundësinë e modifikimit të sallës aktuale të KK. Diskutime tjera nuk ka, atëherë këtë plan pune e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 7. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF

Aprovoj

Plani i punës i Kuvendit të Komunës për vitin 2026. Ky Plan pune i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

3. Propozim Vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSB;

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika Troni: KKSB shihet se është në përbërje prej 15 anëtarëve. Unë mendoj se nuk mund të jetë i plotë ky këshill, pa një përfaqësues nga sektori i shëndetësisë, pasi që siguria e qytetarëve është e lidhur ngushtë me shëndetin publik. Në rast të emergjencave, epidemish apo aksidentesh, vetëm shëndetësia mundet me dhënë udhëzime profesionale për mbrojtjen e komunitetit. Propozoj që në këtë këshill të shtohet edhe një përfaqësues nga Shëndetësia dhe një përfaqësues nga Këshilli rinor apo nga organizata rinore lokale, pasi nuk të përfshirë në këtë këshill. Rinia është faktor kyç në siguri dhe zhvillim, ashtu që pa përfaqësimin e tij në këtë këshill, nuk mundet të pasqyroj komunitetin e rinisë. Pasi numri nuk ishte i kufizuar i anëtarëve të KKSB, mendoj se duhet me i shtuar këta dy përfaqësues, në të kundërtën ky këshill pa një përfaqësues të shëndetësisë dhe një përfaqësues të rinisë nuk është i kompletuar. Unë me herët e di se ka qenë në KKSB drejtori i QKMF.

znj. Ardita Rrahmani: Numri është kufizuar dhe përfaqësuesit e KKSB janë të caktuar në bazë të pozitës se caktuar që kanë.

Kryetari i Komunës- Sabedin Vishi: Drejtori i QKMF nuk ka qenë i përfaqësuar në KKSB, ndërkaq ka qenë i përfaqësuar në Shtabin emergjent, i cili është formua në kohën e pandemisë. Ne mundemi me përcjellë kështu në KK, nëse ka hapësirë për me u përfaqësuar drejtori i shëndetësisë, e marrim parasysht kërkesën tuaj. Sa e di unë, përfaqësimi në KKSB është i përcaktuar në bazë të pozitave që kanë anëtarët e KKSB.

Kryesuesi i Kuvendit Diskutime tjera nuk ka, atëherë këtë Propozim Vendimin për formimin e KKSB e shtroj në votim për aprovim me ia kaluar në procedurë të KK dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 7. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF

Aprovoj

Propozim Vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSB. Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

4. Propozim Vendimi për themelimin e Komisionit komunal të Aksionarëve për KRM "Pastërtia" Sh. A- Njësia në Kaçanik;

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika Troni: Kërkoj nga drejtori i DSHPE të jep sqarime me të hollësishme në këtë pikë.

z. Arian Teneqja: Sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike në fuqi, përfaqësimi i komunës në këtë komision përbëhet prej 3 anëtarëve. Një anëtarë caktohet nga kryetari, 2 anëtarë caktohen nga KK.

znj. Kadrije Lika Troni: Kërkoj të dijë a është përcaktuar emri i anëtarit nga Ekzekutivi, ndërkaq parashtroj pyetje se kujt i takojnë 2 anëtarë që caktohen nga KK? A është e ligjshme që anëtarët e mëparshëm të shkarkohen automatikisht pa ardhur në KK një vendim për shfuqizimin e vendimit të mëhershëm për formim të komisionit.

Kryetari i Komunës: Ende nuk jam përcaktuar për anëtarin nga ekzekutivi, ndërkaq për 2 anëtarët nga KK, përcaktoheni në KK, përfaqësohen kandidatët që marrin shumicën e votave.

Kryesuesi i Kuvendit: Në ligj shkruan që pas marrjes së vendimit për anëtarë të komisionit, anëtarët e mëhershëm shkarkohen automatikisht.

znj. Kadrije Lika Troni: Çdo vendim që merret në KK, duhet me u shfuqizuar përmes KK. Kështu është vepruar edhe me herët. Unë mendoj se njëherë duhet me ardhur shfuqizimi i atij vendimi në KK, pastaj me u emërua komisioni i ri.

znj. Arlinda Rakoci Raka: Unë kam qenë pjesë e komisionit në mandatin e kaluar të KK. Komisioni ka mandat 4 vjet. Me zgjedhjen e anëtarëve të ri, ju pushon mandati anëtarëve tjerë.

z. Kijani Zeneli: Kjo lëndë nuk është e kompletuar, këtu nuk është diçka në rregull dhe unë jam kundër formimit të këtij komisioni. Këtu nuk kemi një vendim që e saktëson në detaje emërimin e këtij komisioni.

Kryesuesi i Kuvendit: Është shënuar në Propozim Vendim që me emërimin e anëtarëve të ri, shkarkohet komisioni i deritanishëm.

z. Kijani Zeneli: Është e drejta e Kryetarit të komunës për emërimin e një anëtar nga Ekzekutivi, ndërkaq 2 anëtarët tjerë duhet me u specifikuar se në çfarë forme emërohen, a janë pjesë e koalicionit. Pa u definuar kjo çështje, unë do të jam kundër këtij vendimi.

znj. Ernesta Krasniqi: Para 4 viteve a ka qenë i njëjti propozim, sa e di unë, ka pasur përfaqësim nga secila parti politike.

z. Arian Teneqja: Ligji për Ndërmarrjet publike, neni 5.2 e thekson se një anëtar caktohet nga Kryetari i Komunës, ndërkaq 2 anëtarët tjerë i emëron KK, nuk është e përcaktuar se kënd e emëron KK, ata që marrin shumicën e votave, emërohen anëtarë të komisionit.

z. Kijani Zeneli: Për mua kjo është e pa pranueshme.

znj. Kadrije Lika Troni: Neve këtu edhe në KPF na është thënë se çdo vendim që e merr KK, shfuqizohet nga KK.

znj. Ardita Rrahmani: Po e kanë potencuar këtu me një pikë të Propozim Vendimit. Në parim është ashtu siç po thoni ju, se jam edhe juriste, por në anën tjetër jemi me mandat. Sikurse ne që jemi anëtarë të KK, nuk ka nevojë KK me na shkarkuar kur t 'na përfundon mandati.

Kryesuesi i Kuvendit: Është e specifikuar në Propozim Vendim se shkarkohen me automatizëm, pa marrë vendim tjetër.

Kryetari i Komunës: Kjo si po e thoni ju, atëherë ne duhet me bërë shkarkimin edhe të anëtarëve të KKS, që iu përfundon mandati me themelimin e KKS të kësaj legjislature. Të Komitetet obliguese janë të caktuara me ligj përfaqësimi sipas subjekteve politike, ndërsa të shoqëritë aksionare, që ka aksione komuna, e bëjmë propozimin e anëtarëve dhe mbarëvajtjen e tyre.

z. Arian Teneqja: Nëse e keni pa një pikë, është që përcakton emërimin e anëtarëve dhe nuk ka nevojë për dy vendime, sepse me emërimin e anëtarëve të ri, shkarkohen me automatizëm anëtarët e deritanishëm.

znj. Ardita Rrahmani; Mendoj se është e jashtëligjshme nëse ne vendosim të e shfuqizojmë një komision të cilëve iu ka përfunduar mandati.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me 6 votë Për, Kundër 1-Kijani Zeneli, Abstenim nuk ka. Prezentë 7. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF,

Aprovoj

Propozim Vendimi për themelimin e Komisionit komunal të Aksionarëve për KRM “Pastërtia” Sh. A- Njësia në Kaçanik. Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

5. Propozim Vendimi për miratimin e Raportit përfundimtar të komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, në fshatin Ivajë;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin iu kemi dërguar edhe njëherë, për shkak se nuk ka qenë i përpunuar mirë. Ndoshta ju dërguam pak me vonesë, edhe në KK e kemi dërguar me ndryshime, fotot janë bërë me ngjyra për shkak të dukshmërisë me të mirë. E hapi diskutimin:

z. Bashkim Krasniqi: Përshëndetje për Kryetarin e komunës, se tani erdhi, Mendoj se ky vendim është shumë i mirë, komisioni ka qenë adekuat, e ka bërë vlerësimin e dëmeve dhe besoj se e ka vlerësuar në mënyrë të drejtë. Është mirë që po bëhet kompensimi i dëmit, që me ia ndihmuar pakëz dëmtuesit që ka pësuar nga demet e shkaktuara, se dëmi moral që iu ka shkaktuar fermerit, shkon kohë deri sa të sanohet, por kjo është mirë që se paku me ia lehtësuar dëmin material që iu ka shkaktuar. Të dhënat janë pasqyruar mirë, shpresoj të realizohet.

Kryesuesi i Kuvendit: Me ndryshimet që janë bërë, fotot janë bërë me mirë, vendimi shkon në ministri për vlerësimin e tij. Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri me ia kaluar KK në procedurë. Prezentë 7. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF

Aprovoj

Propozim Vendimi për miratimin e Raportit përfundimtar të komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, në fshatin Ivajë. Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

znj. Kadrije Lika Troni: Kryesues, harrova me potencuar me herët që të pika për formimin e komisionit komunal të aksionarëve KRU “Pastërtia”, e kam vërejtur një gabim teknik, thuhet që KPF në mbledhjen e datës 19.01.2026 të shqytoj këtë pikë, ndërkaq sot është data 27 janar.

Kryesuesi i Kuvendit: Mund të ketë gabime, e shikojmë.

6. Deklaratë mbi eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike;

Kryesuesi i Kuvendit: Është një Deklaratë mbështetëse me 5 pikë, nëse doni ju lexoj. Mirë atëherë nëse nuk ka nevojë me lexuar, e hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Mendoj se duhet ti qëndrojmë prapa kësaj marrëveshje për 4 vite sa e kemi mandatin.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim me ia kaluar KK në procedurë këtë deklaratë. Rezultati i votimit është njëzëri Për. Prezentë 7. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF,

Aprovoj

Deklaratë mbi eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike. Kjo Deklaratë Mbështetëse, i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, mbledhja i përfundoj punimet në ora 11:30. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët 07.

Mbledhja e I (parë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës e vitit 2026 e legjislaturës së 8, do të mbahet me 30.01.2026 (e premte) në ora 11:00.

Procesmbajtës
Makfiro Malsiu

Malsiu

Kryesues i Kuvendit
Selajdin Troni

